



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Administrim Biznesi”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “POLIS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Assoc. Prof. Dr. Eglantina Hysa

2. Assoc. Prof. Dr. Jonida Teta

Qershor/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, ofruar nga
Universiteti “Polis”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Polis”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 378, dt. 23.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve:	13 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Polis” është institucion jopublik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 698, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, i cili ofron studime të nivelit universitar në tre Fakultete dhe një Qendër:

- *Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn;*
- ***Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban;***
- *Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim;*
- *Qendra Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore e Inovacionit.*


Universiteti “Polis” është akredituar institucionalisht, konkretisht, me vendimin Nr. 113, datë 15.12.2017 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 6 vite akademike dhe afat vlefshmërie të akreditimit deri më 14.12.2023.

Programi objekt vlerësimi Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, është hapur sipas Urdhërit të MAS Nr. 378, datë 23.09.2021, i cili realizohet me 120 kredite në gjuhën shqipe me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Programi organizohet nga Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban, me mbështetjen e Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban.

Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban është i organizuar në dy departamente dhe një qendër kërkimore:

- ***Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban;***
- *Departamenti i Mjedisit;*
- *Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë.*

Programi Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” synon të ofrojë arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e administrim biznesi. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Assoc. Prof. Dr. Eglantina Hysa dhe Assoc. Prof. Dr. Jonida Teta, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Ersi Dako, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njëjësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, Departamentin Planifikim dhe Menaxhim Urban. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë UP, Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban në datat 23 dhe 24 Mars 2023. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (UP, Fakultetin e Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban), u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e Fakultetit të Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, Përgjegjësin e Departamentit Planifikim dhe Menaxhim Urban, Grupin e Vetëvlerësimit, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.

Më datë 01.06.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 48/18 Prot., datë 01.06.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 07.06.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 450/23 Prot., datë 07.06.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1/Kriteri 1 (cituar gabim nga IAL në komente si kriteri 3):

Komenti GVJ: “Megjithatë, në lidhje me ndarjen sipas kategorive formuese, nga A në E (tabela 9), kategoria D është 7.5% (9 ECTS), ndërkohë që sipas VKM 41, e ndryshuar kërkohet që kjo kategori të jetë 10 %, ndaj GVJ rekomandon që Departamenti të marrë masat përkatëse që ky program studimi të jetë në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, e ndryshuar.”

Komenti IAL: “Duke patur parasysh që programi është riorganizuar me Urdhër MAS Nr. 378, datë 23.09.2021, ku tipet e veprimtarive janë miratuar me ndarjet si më lart. Nga departamenti dhe fakulteti përgjegjës për programin në fjalë është gjykuar që ndryshimet të reflektohen pas përfundimit të brezit të parë të studentëve në këtë program studimi”.

GVJ i qëndron konstatimit dhe rekomandimit të dhënë në raport që Departamenti duhet të marrë masat përkatëse që ky program studimi të jetë në përputhje të plotë me VKM Nr. 41/2018, e ndryshuar në lidhje me ndarjen sipas kategorive formuese, nga A në E (tabela 9)”. **Për sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1/Kriteri 8 (cituar gabim nga IAL në komente si Standardi II.1, kriteri 9, fq.11):

Komenti GVJ: “Pavarësisht faktit që aktet ligjore/nënligjore kanë hyrë në fuqi, duke qenë se IAL nuk ka përcjellë informacion/dokumentacion për argumentimin e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ e ka të pamundur të vlerësojë e gjykojë përmbushjen e tij.”

Komenti IAL: “Universiteti POLIS, disponon një kodifikim të brendshëm për të gjitha lëndët e ofruara për çdo program studimi. Ky kodifikim ka për qëllim lehtësimin e menaxhimit administrativ të programeve në sistemin PITAGORA. Ndërsa, procesi i kodifikimit të programeve sipas Ligjit 80/2015, është një proces që ende nuk është finalizuar jo vetëm për POLIS, por edhe për të gjitha IAL-të në vend.”

GVJ i qëndron konstatimit dhe rekomandimit të dhënë, mbështetur dhe në referencën Aneks 44. Plani mësimor MSc.AB., ku kodifikimi i brendshëm është i paqartë dhe në disa raste dhe mungon. **Për sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.3/Kriteri 4 (cituar gabim nga IAL në komente si Standardi II.3, Kriteri 9):

- Komenti GVJ: “GVJ konstaton se në lëndën “Auditim i Brendshëm” apo “Auditim Financiar”, vetëm 20% e notës vlerësohet gjatë vitit dhe 80% në provimin përfundimtar. GVJ rekomandon që studenti të vlerësohet në kufijtë

40% deri 50 % nga elementët gjatë vitit dhe 50% deri 60% nga provimi përfundimtar.”

Komenti IAL: “Lidhur me mënyrën e vlerësimit për çdo lëndë të ofruar në programet mësimore, U_POLIS respekton legjislacionin, në rastin konkret Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 57 (pika 7): “Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”, strategjinë institucionale mbi ndërkombëtarizimin si dhe legjislacionet ndërkombëtare (Procesi i Bolonjës, EHEA, EUA etj) në lirinë akademike si një themel për çdo institucion arsimor që aspiron të ndërkombëtarizohet dhe të rankohet në këto nivele, siç është dhe Universitetin POLIS. Lidhur me rastin konkret të lëndës “Auditim Financiar”, ju informojmë që kjo lëndë është zhvilluar nga pedagogë dhe ekspertë të auditimit, (madje pedagogu Erjon Saraci, mban dhe titullin FCCA, titulli më i lartë i kualifikimit profesional si ekspert kontabël-financiar i miratuar në nivel ndërkombëtar nga “Association of Chartered Accountants (ACCA)”. Mbështetur në eksperiencat e pedagogëve lënda nuk mund të zhvillohet e copëzuar me detyra kursi dhe se natyra e lëndës kërkon provim përfundimtar të konsoliduar dhe me peshë të lartë, por për të arritur në testin përfundimtar pedagogët e lëndës kanë zhvilluar në mënyrë sistematike seminare ushtrimore, ku ushtrime dhe situata të ngjashme studentët i gjejnë edhe në testin përfundimtar. Më tej, duhet theksuar, që pikët e ushtrimeve shpërndahen në komponentin 20% gjatë gjithë semestrit. Pra, në aspektin cilësor, ka një angazhim dhe përfshirje sistematike të studentëve. Ndarja e peshës në formatin 20%-80% nuk është një aspekt mirëfilltazi sasior, më shumë një çështje e cilësisë dhe e përgatitjes psikologjike e studentëve, që në lëndë të caktuara, raste konkrete në korporata, apo teste nga organizata ndërkombëtare, studentët të jenë të mirëpërgatitur. Gjithashtu, ne kemi feedback nga studentët (nëpërmjet pyetësorëve të NJBSC-së) të cilët kanë qenë shumë të kënaqur dhe në favor të metodologjisë së aplikuar nga pedagogët për këtë program studimi.”

GVJ në lidhje me rekomandimin që studenti të vlerësohet në kufijtë 40% deri 50 % nga elementët gjatë vitit dhe 50% deri 60% nga provimi përfundimtar, GVJ merr në konsideratë komentet e IAL-së duke konsideruar lirinë akademike. **Raporti në këtë pikë ndryshon përsa i përket shpërndarjes së vlerësimit gjatë vitit dhe atij në provimin përfundimtar.**

- Komenti GVJ: “a) tematikat e lëndës të kenë një shpërndarje javore, për 14 javë”.

Komenti IAL: “Ne gjykojmë që, ky sugjerim është i drejtë në rastet kur një temë mësimore shterohet brenda një seance mësimore ose brenda një jave. Mirëpo, jo detyrimisht javët e leksioneve/seminareve përputhen me numrin e tematikave, që do të thotë se, një temë mund të zhvillohet në më shumë se një

leksion/seminar. Përsëri, kjo mbetet në diskrecion të pedagogut, të cili i është besuar angazhimi dhe në respekt të lirisë akademike dhe profesionale”.

GVJ i qëndron konstatimit dhe rekomandimit të dhënë në lidhje me formatin standard të syllabuseve që përmbajnë të gjithë elementët përkatës komfort ligjit (standard i detajuar me elementët përkatës sipas VKM 41/2018, i ndryshuar), ku temat e lëndës përkatëse të kenë si shpjegim prej rreth një paragrafi për çdo temë të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe); tematikat e lëndës të kenë një shpërndarje javore, për 14 javë (dhe kur një temë është e shpërndarë në më shumë se dy javë, studentët duhet të kenë informacionin e saktë në lidhje me trajtimin e temave javore). **Për sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- Komenti GVJ: *“b) literatura e përdorur të jetë e viteve të fundit”.*

Komenti IAL: *“Duke qene se, programi Msc. Administrim Biznes, është licensuar në gjuhën Shqipe, e duke marrë parasysh se prodhimitaria e teksteve akademike në Shqipëri është në disa raste e kufizuar e në disa të tjera jo e përditësuar, atëherë literatura e viteve të fundit në gjuhën shqipe mbetet një sfidë jo vetëm për U_POLIS por për të gjithë sistemin arsimor shqiptar. Përpos kësaj dobësie të sistemit, pedagogët janë përpjekur të mbajnë një literaturë domethënëse dhe dobiprurëse, duke i përditësuar studentët me materialet e tyre si dispensa, ushtrime, raste studimore, etj. Por, në çdo rast studentët njoftohen dhe i bëhet e ditur që në fillim të vitit akademik se kanë mundësi të aksesojnë literaturat më të fundit në këtë fushë nëpërmjet e-library që Universiteti POLIS disponon, EBSCO dhe JSTOR”.*

GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë në lidhje me cilësinë e syllabuseve ku duhet të përfshihet literatura e viteve të fundit sipas kërkesave të VKM 41/2018, i ndryshuar. **Për sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

- Komenti GVJ: *“c) shpërndarja e vlerësimit të mësimnxënies të jetë në kufijtë 40% deri 50% nga elementët gjatë vitit dhe 50% deri 60% nga provimi përfundimtar”.*

Komenti IAL: *“Ndonëse U_POLIS është përpjekur të jetë i përpikt në përmbajtje me programin e lëndës të miratuar, ku programet e lëndëve të Master i Shkencave në Administrim Biznesi përmbajnë të gjitha elementët e kërkuara nga VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Ne gjykojmë se, akademikisht do të ishte e pamundur dhe në kundërshtim me autonomia institucionale dhe lirinë akademike që të imponohet redaktimi i silabuseve, kjo për arsye se ka lëndë në të cilat pedagogu mund të operojë me dispensa personale, raster studimore, video cases, ushtrime, vizita në terren, etj. Ky është një sugjerim parimisht i vlefshëm, por që në lëndë të caktuara nuk është e thënë të gjejë aplikim, (psh.*

studentët mund të kenë një projekt të cilin e zhvillojnë me pjesë të shtrira gjatë gjithë semestrit). Pra, shpërndarja e vlerësimit sipas përqindjeve nuk përbën një rregull, por një hapësirë hulumtimi rast pas rasti, ku çdo lëndë trajtohet “ad hoc” dhe në respekt të ekspertizës profesionale të pedagogut dhe lirisë së tij akademike”.

GVJ, në lidhje me rekomandimin që studenti të vlerësohet në kufijtë 40% deri 50 % nga elementët gjatë vitit dhe 50% deri 60% nga provimi përfundimtar, ashtu sikurse cituar edhe më lart, merr në konsideratë komentet e IAL-së duke konsideruar lirinë akademike. **Raporti në këtë pikë ndryshon përsa i përket shpërndarjes së vlerësimit gjatë vitit dhe atij në provimin përfundimtar.**

4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.4/Kriteri 4:

Komenti GVJ: *“GVJ rekomandon që programet e lëndëve mësimore duhet të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. Njëkohësisht, GVJ rekomandon se programi i studimit duhet të ketë praktika laboratorike për lëndë të caktuara, si “Biznesi Dixhital”, “Financa”, apo dhe “Metodat e Kërkimit Shkencor”, e cila ndihmon në adaptimin më të shpejtë të studentëve me kërkesat e tregut të punës.”*

Komenti IAL: *“Çështja e praktikave dhe orientimit sipërmarrës është filozofi e programit dhe shkon përtej lëndëve specifike. Për këtë arsye, koordinatori i programi mbështetur nga U_POLIS ka punuar fuqimisht duke krijuar një infrastrukturë bashkëpunimesh me aktorë të ndryshëm të tregut si psh. Deloitte, Balfin, Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, Coca Cola, AADF, etj. kjo ka bërë të mundur që studentët të kenë mundësi të plotësojnë njohuritë teorike me ato praktikë të fjalës së fundit të praktikës së biznesit dhe inovacionit. Pra, mund të themi se jo vetëm mbështesim këtë sugjerim kuptimplotë, por mbi të gjitha tashmë e kemi praktikë të konsoliduar dhe të vazhdueshme për çdo lëndë që zhvillohet në këtë program. Më shumë se sa orë “laboratorike”, studentëve i ofrohen orë reale të praktikës së biznesit. Kjo dëshmohet nga një listë aktivitetesh dhe workshopesh të cilat i gjeni në një shtojcë të re që përgatitur enkas (Shtojca A: Lista e workshopeve, vizitave në terren, etj). Për ta konkretizuar me një nga shembujt e cituar, konkretisht lënda “Biznes Dixhital”, ofruar në bashkëpunim nga Dr. Merita Toska dhe MBA Erion Nako, studentët kanë përfituar nga vizita në terren tek TechSpace, Protik dhe SDA Albania ku janë ballafaquar me praktikat më inovative të digjitalizimit të biznesit. Kjo shkon në të njëjtën linjë me sugjerimin e ekspertëve/vlerësuesve të jashtëm si edhe me filozofinë e Polis Business School.”*

Krahas orëve reale të praktikës së biznesit që IAL dhe programi i studimit i ofron studentëve, GVJ i qëndron rekomandimit që programi i studimit duhet të ketë praktika të zhvillimit të këtij programi në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike, pasi për lëndët e lartpërmendura njohuritë në aplikime laboratorike janë të një rëndësie të


veçantë. Ky informacion duhet të jetë i detajuar në syllabuset përkatëse. **Për sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

5. Lidhur me komentën e institucionit për Standardin IV.1, fq. 38:

Komenti GVJ: *“Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në këtë program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc., jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë “Profesor”, si dhe ngarkesa mësimore nuk mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv, sikurse kërkohet nga parashikimet ligjore në fuqi”.*

Komenti IAL: *“Sikurse mund të shikohet nga Plani Mësimor i dorëzuar nëpërmjet DVV (Aneks 44), stafi përgjegjës për lëndët e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi disponojnë minimalisht gradën shkencore Dr.”.*

Lidhur me komentën e institucionit, GVJ, bazuar në të dhënat e paraqitura nga Institucioni (tabelat përmbledhëse të marra gjatë vizitës, tabela 6), i qëndron konstatimit të paraqitur në raport për këtë pikë. Sikurse paraqitur edhe në raport, në vitin akademik **21-22** janë angazhuar: 6 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., dhe 5 Dr., dhe 7 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Dr. dhe **2 Msc.**, ndërsa në vitin akademik **22-23** janë angazhuar: 12 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 8 Dr. dhe **2 Msc.**, dhe **9 PAK**, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 2 Dr. dhe **5 Msc.** Sikurse mund të konstatohet nga këto të dhëna, rezulton se në këtë program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc. **Për sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Administrim Biznesi”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, ofruar nga Universiteti Polis (UP)/ Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMU), në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program relativisht specifik dhe bashkëkohor ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studentëve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit të bizneseve të vendit në veçanti.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullator të institucionit. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e UP. Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik dhe zhvillimit të bizneseve të vendit.</p> <p><i>Aneks 1 Statuti Universiteti POLIS</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UP dhe Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si njësi kryesore e tij, të shprehura në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e aplikimit të programeve inxhinierike dhe informatike në përgjithësi dhe të administrim biznesit në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban, si pjesë e FPMU të UP. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë së biznesit të lidhura me aplikimin e programeve informatike bashkëkohore në fushën e administrim biznesit duke ofruar dhe kurse si Biznes Dixhital, Inovacion dhe Sipërmarrje, Ekonomi Qarkulluese.</p>

	<p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” është hartuar në përputhje me Statutin e UP dhe rregulloret përkatëse të këtij institucioni që janë miratuar nga instancat përkatëse në vitin 2017 dhe me Urdhër miratim ndryshimi të Statutit në vitin 2022, që reflektuan ndryshimet në funksion të ligjit aktual në fuqi të arsimit të lartë. Ky program, i cili ka ardhur si rezultat i një riorganizimi me Urdhër të MASR Nr. 378, datë 23.09.2021, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, Departamentit Planifikim dhe Menaxhim Urban, për të zhvilluar këtë program. Strategjia e institucionit që përkon po me këtë periudhë (2021-2026) mëshiron edhe objektivat e këtij programi.</p> <p>Statuti dhe rregullorja e UP përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Kjo rregullore është miratuar në vitin 2018 me vendim Senati, duke reflektuar edhe ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Krahas kësaj baze rregullative, edhe vetë njësia bazë, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban që mbulon këtë program, ka hartuar rregulloren e programit MSH në AB ku janë të përcaktuara edhe drejtimet kryesore të këtij programi.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_Universiteti POLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 38_Urdher Nr. 378, date 23.09.2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë dhe bizneseve. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e menaxhimit me fokus kryesor sektorin e biznesit i shërben këtij zhvillimi. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në fushën e menaxhimit dhe administrim biznesit që po përbëjnë një drejtim të rëndësishëm edhe për nevojat e tregut për specialist me njohuri në këto fusha. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e administrim biznesit nëpërmjet programeve informatike bashkëkohore të kërkuara nga sektori financiar privat që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive të administrim biznesit.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UP dhe Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si njësi kryesore e tij dhe në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullator të institucionit. Gjithashtu ky program studimi është në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Organizimi i UP, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MSH në “Administrim Biznesi”, duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban dhe Departamenti i Planifikimit dhe Menaxhimit Urban që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Kështu, bazuar në organigramën e Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si njësi kryesore e programit, ai përfshin dy Departamente dhe një Qendër Kërkimore me një personel akademik efektiv (PAE) prej 31 punonjësish.</p> <p><i>Aneks 15.3_ Organigrama e stafuar</i> <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_ Tabelat përmbledhese (Tabela 1)</i></p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Programi MSH në “Administrim Biznesi” funksionon në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, Statutin dhe Rregulloren e UP, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si një ndër Fakultetet e UP.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban, i cili që në emërtim është në përputhje me objektivin e këtij programi. <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i>						
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.						
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.						
Konkluzione	<i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion, përkatësisht me Fakultetin e Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban dhe Departamentin Planifikim dhe Menaxhim Urban.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të këtij programi është Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të

	<p>miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit dhe në rregulloren e Fakultetit. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 53_Raporti Vjetor 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UP ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe me një numër institucionesh dhe subjektsh ekonomike shtetërore dhe private. Këto marrëveshje bashkëpunimi janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si ERASMUS +, etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. Gjatë vizitës në institucion u evidentua edhe përfshirja e lektorëve të huaj për të dhënë leksione për tema të veçanta, ku një temë specifike është trajtuar me studentët e këtij programi dhe të programeve të tjera në fushën e ekonomisë.</p> <p><i>Aneks 47_Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UP ka një sërë marrëveshesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në Institutin, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët kontribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrieren të tyre.</p> <p><i>Aneks 27_Politika mbeshtetese dhe marreveshje bashkepunimi MSc.AB</i></p>

	<i>Aneks 47_Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Departamenti Planifikim dhe Menaxhimit Urban nuk harton raporte të veçanta lidhur me bashkëpunimin me entet e ndryshme. Megjithatë, në nivel njësie kryesore GVJ konstatoi se gjendet një dokument në lidhje me politikat e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit ku detajohen fokuset, pritshmëritë dhe ecuritë e marrëveshjeve të mundshme me programin në fjalë. Kjo u konfirmua dhe nga bashkëbisedimet me stafin akademik të këtij programi studimi.</p> <p><i>Aneks 27_Politika mbeshtetese dhe marreveshje bashkepunimi MSc.AB</i> <i>Minutat e vizitës në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<i>Universiteti Polis siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Institucioni paraqet një listë të larmishme bashkëpunimesh, e cila përfshin institucione të huaja akademike homologe, laboratore shkecore, si dhe kompani të profilit të programit te studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të	Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi, si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 120 kredite në dy vitet dhe

<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>me ngarkesë studenti 25 orë në javë. GVJ mendon që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta, departamenti ka mirëpërcaktuar numrin e krediteve në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit që ndryshojnë për lëndë të veçanta.</p> <p><i>Megjithatë, në lidhje me ndarjen sipas kategorive formuese, nga A në E (tabela 9), kategoria D është 7.5% (9 ECTS), ndërkohë që sipas VKM 41, e ndryshuar kërkohet që kjo kategori të jetë 10 %, ndaj GVJ rekomandon që Departamenti të marrë masat përkatëse që ky program studimi të jetë në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, e ndryshuar.</i></p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i> <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabela 9, 10, 13)</i></p>
<p>Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit mesimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së menaxhimit dhe aplikimit praktik të programeve menaxheriale. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të menaxhimit, në fushën e Administrim Biznesit pranë institucioneve administruese apo sipërmarrjeve private si dhe në sektorin publik të analizes se bizneseve. Trajtimi në këtë program të administrim biznesit në fusha të veçanta si biznesi dixhital, ekonomia qarkulluese apo ajo mjedisore e bëjnë këtë program jo vetëm më të plotë dhe bashkëkohor, por dhe unik.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Duke u bazuar në DVV si dhe në syllabuset përkatëse, GVJ konstaton se programi i studimit ka të mirëpërcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse. Konkretisht, praktika profesionale është vlerësuar me 6 kredite dhe ofrohet në semestrin e katërt. Në të njëjtin semestër studentet duhet të përgatisin dhe “Teza dhe Projekt Diploma” e vlerësuar me 9 kredite ku detajet e mbarëvajtjes janë të mirëpërcaktuara në Rregulloren e Diplomimit MSC AB.</p> <p><i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i> <i>Internship - (MSBA 2)</i></p>
<p>Kriteri 4.Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në</p>	<p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</p>

<p>arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Për këto kriteret, IAL ka cituar në RVB se: <i>“Aktet nënligjore për kodifikimin e programeve të studimit nuk janë akoma në fuqi”</i>. GVJ evidenton se janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi aktet ligjore dhe nënligjore në vijim: VKM nr. 310, datë 11.05.2022 <i>“Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>, si dhe Udhëzimi i MAS nr. 31, datë 15.11.2022 <i>“Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p><i>Pavarësisht faktit që aktet ligjore/nënligjore kanë hyrë në fuqi, duke qenë se IAL nuk ka përcjellë informacion/dokumentacion për argumentimin e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ e ka të pamundur të vlerësojë e gjykojë përmbushjen e tij.</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” ofrohet vetëm nga Universiteti “Polis”.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të</i></p>

	<p><i>lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 120 kredite në dy vitet dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë. Përsa i përket ndarjes sipas kategorive formuese (nga A në E), <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti të marrë masat përkatëse që ky program studimi të jetë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të VKM Nr. 41, e ndryshuar. Njëkohësisht, GVJ e kishte të pamundur të vlerësojë e gjykojë përmbushjen e kritereve 7 dhe 8, pasi IAL nuk ka përcjellë informacion/dokumentacion për argumentimin e përmbushjes së këtyre kritereve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UP, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion i Arsimit të Lartë JoPublik, është i organizuar dhe i përbërë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit MSH në “ Administrim Biznesi”. Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, (si një nga 3 fakultetet e UP) si njësi kryesore e këtij programi përfshin 3 njësi bazë ku Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si një prej tyre është përgjegjës i zhvillimit të këtij programi, duke përmbushur kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>UP i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 113, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite akademike dhe afat të vlefshmërisë së akreditimit deri më 14.12.2023.</p> <p>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ka në përbërje njësitë bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban; 2. Departamenti i Mjedisit; 3. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë; <p>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga 41 Personel Akademik gjithsej, nga ku 31 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 9</p>

Personel Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban	PAE	PAK
Prof. Dr.	5	1
Prof. As. Dr.	1	1
Dr. / PhD.	13	2
MSc.	12	5
Totali	31	9
	41	

Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezulton se çdo njësi bazë e FPMMU plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor.

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë përbërje:


Kualifikimi i stafit	Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	1
Prof.Asoc	1	1
Dr/PhD	7	2
Msc	5	5
Gjithsej	16	9

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2021-2022 ka patur këtë përbërje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1
Prof.Asoc		
Dr/PhD	8	4
Msc	3	2
Gjithsej	13	7

Aneks 2_U_POLIS Development Strategy 21-26

	<i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabelat 1, 2)</i>		
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, evidentohet se Departamenti angazhon personel akademik për të ndjekur ecurinë e zhvillimit të praktikave të studentëve në semestrin e katër të programit. Gjithashtu personeli ndihmës që është në strukturën e Departamentit angazhohet në zhvillimin korrekt të mësimave laboratorike dhe dorëzimin e projekteve nga studentët e programit. <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabelat 1, 2)</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët.</i>		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga shqyrtimi i rregullores së Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit dhe rregullores së këtij programi janë të përcaktuara qartë gjithë problematikat lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor-shkencor. Koordinator i programit të studimit organizon takime çdo muaj me stafin akademik dhe atë drejtues për të diskutuar mbarëvajtjen dhe çështjet e lidhura ngushtë me programin e studimit. Nga vizita në institucion evidentuam që Përgjegjësi i Departamentit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban si dhe Koordinator i këtij programi monitorojnë këtë program studimi në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e programit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, etj. <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i> <i>Aneks 33_Vendim_per emerimin e koordinatorëve te programeve 22-23</i>		
Konkluzione	<i>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban dhe Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban, përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Gjithashtu GVJ vlerësoi përmbushjen e standardit në angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe atij administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike, si dhe përcaktimin e një koordinatori për monitorimin sa më efikas të këtij PS.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
			X



Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga institucioni dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si njësi kryesore dhe Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat janë të arshvuara por edhe të publikuara në website e IAL.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në programin mësimor jepen qartë informacionet që kanë të bëjnë me ngarkesën mësimore, vlerësimin e njohurive, metodat e mësimdhënies, kriteret mbi frekuentimin dhe realizimin e praktikës, etj. Ky informacion vihet në dispozicion edhe elektronikisht në sistemin PITAGORA, ku çdo student sheh programin e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Marrja e informacionit për kriteret dhe procesin për tu regjistruar në këtë program si dhe për studentët që po e zhvillojnë këtë program, si dhe mundësia e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullores së studimeve të UP; • Rregullores së Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban; • Rregullores së programit MSH në “Administrim Biznesi”. <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme 2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Website: https://universitetipolis.edu.al/en/master-of-science-in-business-administration-mba/</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit MSH. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë shumicën e elementëve të përcaktuara në Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si:</p>

brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

- Emërtimi i lëndës/modulit;
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda;
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën;
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit;
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës;
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë;
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik;
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS;
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre;
- Format e vlerësimit të studentëve;
- Detyrimet e studentit për lëndën;
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Duke parë në detaje syllabusin e çdo lënde të këtij program studimi, GVJ konstaton se *pjesa më e madhe e syllabuseve nuk kanë formatin standard që përmbajnë të gjithë elementët përkatës komfort ligjit. Gjithashtu, jo të gjithë syllabuset kanë të listuara tematikat për 14 javë që janë pjesë e semestrit. Njëkohësisht, vetëm pak syllabuse kanë si referencë literaturë të viteve të fundit. Për sa më lart, rekomandohet që për këtë program studimi:*

1. të përdoret formati standard i detajuar me elementët përkatës sipas VKM 41/2018, i ndryshuar. Temat e lëndës të ketë si shpjegim prej rreth një paragrafi për çdo temë të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe;
2. tematikat e lëndës të kenë një shpërndarje javore, për 14 javë;
3. literatura e përdorur të jetë e viteve të fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Shpërndarja e vlerësimit gjatë vitit dhe atij në provimin përfundimtar ndyshon sipas lëndëve.


Aneks 29_Syllabuset e programit

Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB

Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore


<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Ky program ka dy vite që zhvillohet dhe titullarët e lëndëve dorëzojnë në çdo fillim viti programin e lëndës. Nga takimi me stafin rezultojnë se në programe reflektohen përditësimet sidomos lidhur me literaturë bashkëkohore.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i> <i>Vizita në institucion, takimi në stafin akademik</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Megjithatë, në lidhje me përmirësimin dhe përshtatjen me Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, GVJ rekomandon si në vijim:</i></p> <p><i>a) të përdoret formati standard i detajuar me elementët përkatës sipas VKM 41/2018, i ndryshuar. Temat e lëndës të ketë si shpjegim prej rreth një paragrafi për çdo temë të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe);</i></p> <p><i>b) tematikat e lëndës të kenë një shpërndarje javore, për 14 javë;</i></p> <p><i>c) literatura e përdorur të jetë e viteve të fundit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit evidentohet se në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e Administrim Biznesit. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sektorit e biznesit. Në program dominojnë lëndët e fokusuar në objektin e tij që është menaxhimi në fusha apo sektorë të ndryshëm të biznesit.</p> <p><i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i> <i>Vizita në institucion, takimi në stafin akademik</i></p>



<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e menaxhimit edhe me mundësinë për të realizuar kërkime shkencore në sektorë të veçantë të cilat ballafaqohen me natyrë të ndryshme të bizneseve. Nga ana tjetër, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të bizneseve.</p> <p>Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p><i>Aneks 44 _Plani mesimor MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialistë në administrim biznes. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është menaxhimi në sektorët e fushës së biznesit. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimit të studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Vlefshmëria e këtij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu që mbështet nevojën për specialistë të fushës.</p> <p><i>Aneks 11 _Analiza e tregut te punes MSc. AB</i> <i>Aneks 44 _Plani mesimor MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar nga e institucioni, si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program, vërejmë se ka një raport të drejtë mes formimit teorik dhe atij praktik të studentëve që kanë preferuar të jenë menaxherë në sektorët e biznesit. Në vijim edhe të argumentimit të trajtuar më lart lidhur me strukturën e programit, shohim që ka harmonizim të trajtimeve teorike në lëndët e formimit të përgjithshëm, me grupin dominues të lëndëve të formimit profesional. Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve evidentohet se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime të metodave të menaxhimit.</p> <p><i>Për një trajtim më konkret për lëndë specifike, <u>GVJ rekomandon që programi i studimit duhet të ketë praktika të zhvillimit të këtij</u></i></p>

	<p><i>programi në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Praktika të tilla laboratorike mund të përdoren në realizimin e lëndëve si “Biznesi Dixhital”, “Financa”, apo dhe “Metodat e Kërkimit Shkencor”, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së klasave duke u zhvilluar në laborator. Kjo ndihmon në adaptimin më të shpejtë të studentëve me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve, si dhe nga takimi me stafin në institucion, në përgjithësi evidentohet përmbajtja cilësore e elementëve të përcaktuar. Ashtu sikurse është analizuar edhe më sipër, jo të gjithë <i>syllabuset kanë si referencë literaturë të viteve të fundit</i>. Edhe pse ky program ka vetëm 2 vite që po zhvillohet ka plotësime apo axhustime në programe të disa lëndëve me qëllim përmirësimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit. Ky program ka përfshirë lëndë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si Biznes Dixhital, Inovacion dhe Sipërmarrjen, Ekonomi Qarkulluese apo ajo Mjedisore.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi MSH në “Administrim Biznesi” i pajis studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e biznesit, ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit në sektorin e biznesit, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar klima e bizneseve. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin real të biznesit.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit të biznesit, por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektore reale të ekonomisë apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektorëve të tjerë.</p> <p><i>Aneks 2_U_POLIS Development Strategy 21-26</i></p>



	<i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i>		
Konkluzione	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit MSH në “Administrim Biznesi” është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ndonëse ky program është relativisht i ri, <u>GVJ rekomandon</u> që programet e lëndëve mësimore duhet të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. Njëkohësisht, <u>GVJ rekomandon</u> se programi i studimit duhet të ketë praktika laboratorike për lëndë të caktuara, si “Biznesi Dixhital”, “Financa”, apo dhe “Metodat e Kërkimit Shkencor”, e cila ndihmon në adaptimin më të shpejtë të studentëve me kërkesat e tregut të punës.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas DVV, specifikisht sipas evidencës “Politika e Bashkëpunimit dhe Marrëveshjet e Partneritetit në Funkcion të Programit”, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban ka një politikë të miratuar se si marrëveshjet ekzistuese duhet të shërbejnë në përmirësimin e programeve të studimit nëpërmjet konsultimit për kurrikulat në mbështetje të përshtatjes së kërkesave të tregut të punës. Sipas kësaj politike përmirësimi i programit të studimit mund të ndodh ndër të tjera dhe për nevoja të tregut të punës, të sipërmarrjeve dhe bashkëpunëtorëve të institucionit. Duke u bazuar dhe tek diskutimet me stafin drejtues dhe atë akademik të këtij PS, GVJ konstato se Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban ka kontakte të vazhdueshme me institucione partnere si: Ministri të ndryshme, Bashki, Tirana Business Park, kompani të tjera, të cilat japin sugjerime të rëndësishme në lidhje me tregun e punës.</p> <p><i>Aneks 27_Politika mbeshtetese dhe marreveshje bashkepunimi MSc.AB</i></p> <p><i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabela 5)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe stafin akademik të programit.</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, u evidentua përfshirja e studentëve në përmirësimet në programin përkatës. Studentët e këtij programi kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve, të shpërndara për ta në fund të semestrit përkatës nga Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me pedagogët e lëndëve.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i></p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Sipas DVV dhe duke u bazuar dhe tek diskutimet me stafin drejtues dhe atë akademik të këtij PS, GVJ konstaton se Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban ka kontakte të vazhdueshme me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private, të cilët shërbejnë si konsulentë për përshtatjen e programit të studimit me zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.</p> <p><i>Aneks 27_Politika mbështetese dhe marrëveshje bashkëpunimi MSc.AB</i> <i>Aneks 45_Antaresim CEEMAN</i> <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabela 5)</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe stafin akademik të programit</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UP nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Konkretisht, Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si njësi kryesore dhe Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si njësi bazë e zhvillimit të programit kanë siguruar marrëveshje të rëndësishme në lidhje me fushën e PS të cilat shërbejnë si urë lidhese me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat kryesore të tij në funksion edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet marrjes së njohurive të thelluara dhe të avancuara në fushën e administrim biznesit të cilat janë pjesë e objektivave madhore të institucionit. Në përputhje me objektivat e Institucionit, ky program studimi ka si objektivi: (1) mbështetjen e klimës së biznesit në Shqipëri duke</p>



	<p>ofruar profesionistë të fushës përkatëse; (2) të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve në fushat e ekonomisë sociale dhe biznesit, duke mbështetur kështu zhvillim ekonomik të qëndrueshëm; (3) forcimin e urave lidhëse ndërmjet akademisë dhe biznesit, etj.</p> <p><i>Aneks 44_Plani mesimor MSc.AB</i></p>						
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të përcaktuara në aktet nënligjore. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar na argumentuan axhustime në program sidomos me zhvillimin e modeleve aplikative gjatë trajtimit të projekteve të kursit apo përdorimin e modeleve dixhitale.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik të programit</i></p>						
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Për vetë specifikën e këtij programi i fokusuar në administrim biznes, ai u jep mundësi studentëve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teoriko shkencor dhe aplikativ. Modele biznesi, biznesi dixhital, ekonomia mjedisore apo ajo qarkulluese janë një fokus i gjerë për ndërmarrjen e punimeve shkencore dhe aplikative. Duke qenë se ky program studimi është relativisht i ri, ende nuk ka punime të studentëve të publikuara. Megjithatë nga takimi me studentët dhe stafin, u diskutua përqsja pozitive e të dy palëve të cilët do prezantonin në konferenca shkencore ose do publikonin punimet e tyre.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i></p>						
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban në përmbushje të aktiviteteve kërkimore shkencore ka pasur si burim financimi fondet e projekteve Erasmus + si dhe mbështetje nga institucioni. Nga takimi në institucion u informuam që stafi akademik ka mundësi të përfitojë nga mbështetja financiare që institucioni ofron në rast se stafi akademik prezanton në një konferencë shkencore ose publikon punimet e tyre.</p> <p><i>Aneks 26_Politika ne mbeshtetje te stafit ne kerkimin shkencor</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit MSH në "Administrim Biznesi" garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor nëpërmjet strukturave të ngritura në departament, mundësive financiare nga projekte kombëtare ose ndërkombëtare, dhe pjesëmarrjeve në konferenca shkencore.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.7**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet se Institucioni është aktiv në realizimin e projekteve dhe iniciativave shkencore. Bazuar në dosjen e përcjellë evidentohet se për periudhën 2021-2022 në kuadër institucional, UP është përfshirë në 11 projekte në kuader të thirrjeve kombëtare (3 të tilla) dhe ndërkombëtare (8 të tilla). UP, krahas thirrjes për projekte në kuader të projekteve Erasmus+, ka qenë aktive dhe në përthithjen e fondeve nga AKKSHI duke u bërë pjesë e dy projekteve të financuar nga AKKSHI.</p> <p><i>Aneks 40_Lista e projekteve nderkombetare</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban si njësi kryesore dhe Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si njësi bazë e zhvillimit të programit është aktive në përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. Konkretisht, për vitin 2021-2022, në kuadër institucional, fakulteti dhe departamenti, UP ka hartuar një raport të detajuar në lidhje me përfshirjen e stafit në aktivitete të kërkimit shkencor si dhe në projekte të ndryshme. Ndërkohë, studentët realizojnë kërkime shkencore në kuadër të tezave në përfundim të studimeve të tyre. Njëkohësisht, GVJ konstatoi dhe përfshirjen e studentëve në projekte që kanë në fokus mobilitetet.</p> <p><i>Aneks 23_Raport, Veprimtaria e Kerkimit Shkencor 21-22</i> <i>Aneks 42_Studentët e angazhuar ne projekt</i> https://issuu.com/polisuniversity</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Institucioni, gjatë viteve të fundit, ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave shkencore të organizuara në institucion ose jashtë tij. Bazuar në planin vjetor të aktivitetit kërkimor shkencor të UP, ky institucion ka organizuar aktivitete shkencore të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konferenca e akademikëve të rinj AESOP 2021, ku përfshihen më së shumti studentët; <p>2021 – 15th AESOP (Association of European Schools of Planning) Young Academics Conference “Governing the Unknown. Adaptive Spatial Planning in the age of Uncertainty”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konferenca të tjera ku janë në rang universiteti por që përfshijnë dhe fokusin e Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban;

	<p>2022 – “Investimet në mjedis, investime strategjike për ekonominë, mirëqënien dhe të ardhmen e qëndrueshme”, konferencë në kuadër të Javës së Tokës 2022;</p> <p>2022 – 5th Annual Workshop of TG-WeB, the Western Balkans Network on Territorial Governance, “Challenges, Trends, Gaps and Policy recommendations on the WB-EU cohesion”;</p> <p>2021 – International Symposium “Cities in the Balkans, development challenges, processes and content, in line with EU trends or not?”</p> <p>https://universitetipolis.edu.al/konferenca-kombetare/ https://universitetipolis.edu.al/konferenca-nderkombetare/</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të dosjes së DVV dhe takimit me drejtuesit e institucionit dhe departamentit, konstatoi se programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” ka gjithë bazat dhe strukturën e përshtatshme për të formuar profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Në mbështetje të formimit të profesionistëve vijnë përfshirja në projekte, lëndet e bazë dhe ato inovative të fushës, si dhe marrëveshjet me institucione të lidhura me fushën e PS.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 42_Studentët e angazhuar ne projekt</i> <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabela 5)</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit e institucionit dhe departamentit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>GVJ konstatoi se në rast rekomandimesh nga shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, njësia përgjegjëse ka të gjitha strukturat dhe kapacitetet e nevojshme për të marrë parasysh dhe zbatuar të gjitha aktet ligjore të fushës.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor mbështetur në përfshirjen e gjerë në projekte në kuadër të</i></p>

	<i>projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në aktivitete të shumta shkencore në formë të konferencave akademike me në fokus trendet e fundit të fushës së studimit. GVJ konstatoi se organizohen aktivitete gjithëpërfshirëse si dhe projekte kërkimore të shumta të cilat mundësojnë avancime në njohuri të stafit akademik si dhe të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Mësimdhënia në programin MSH në “Administrim Biznesi” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, rregulloren e Fakultetit (FPMMU) si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 19 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i></p>

	<p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabela 13 dhe 15)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Në mbështetje të një performace më të mirë mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobilitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. Institucioni ka si procedurë të detajuar vlerësimin e pedagogut të lëndës nga studentët, kolegët, dhe forma e vetëvlerësimit. Gjatë konsultimeve me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se çdo ankesë ose sugjerim e adresuar nga studentët ose kolegët merret parasysh për përmirësimin e mësimdhënies dhe përdorimin e formave të reja.</p> <p><i>Aneks 30_CV e stafit akademik</i> <i>Aneks 41_Mobileteti i stafit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e Departamentit rezultoi se FPMMU i UP mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuar në nivel universiteti në lidhje me ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, menaxhimin e klasave, komunikimin, kërkimin shkencor, sistemin e të dhënave, etj.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon kete program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Administrim Biznesit dhe fusha të tjera të lidhura me të. Eksperienca në mësimdhënie e stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përbën dhe realizimi i mësimin online gjatë situatës pandemike. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Vetë</p>

	<p>karakteri aplikativ i disa lëndëve, sidomos të modelimit dhe menaxhimit, rrisin pavarësinë e studentit në këtë proces.</p> <p><i>Aneks 30_CV e stafit akademik</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Njekohësisht NJSBC ndan me departamentin problematikën e dala nga anketimi i studentëve të cilat diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve si psh. në lëndën e Menaxhim Operacionesh.</p> <p><i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se tashmë janë miratuar dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, përkatësisht Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. NJBSC koordinon punën me njësinë bazë që është Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban si njësi bazë e këtij programi. Departamenti ka të caktuar një koordinator të programit që mban kontakte të vazhdueshme me NJBSC-në.</p> <p>Njekohësisht edhe mobilitetet në institucionet partnere në kuadër të projektit ERASMUS + si dhe aktivitetet e organizuara nga departamenti apo fakulteti kanë mbështetur në funksion të përmirësimit të metodave të mësimdhënies, dhe zhvillimin e metodave të reja inovative.</p> <p><i>Aneks 8_Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 41_Mobileteti i stafit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se nëpërmjet suportit administrativ të NJBSC-së, kualifikimeve dhe eksperiencën e stafit akademik, si dhe përfshirjen e stafit në trajnime dhe projekte ndërkombëtare, Universiteti POLIS garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin</i></p>

	<i>profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UP), njësisë kryesore (Rregullore e Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban) dhe rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumenta janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në websiten e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në të; • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre. <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i></p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në forma tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i></p>
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se Institucioni ka të gjitha strukturat e posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre nëpërmjet Rregullores së UP, Rregullores së Fakultetit të Planifikimit,</i>

	<i>Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, rregullores së këtij programi, si dhe Rregullores Didaktike.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3


Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët vlerësohen sipas disa kriterëve gjatë gjithë semestrit. Në përgjithësi, ekzistojnë dy korniza kohore të dedikuara për provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare. Studentëve u kërkohet të punojnë në raste studimore, të bëjnë projekte ose të bëjnë një prezantim sipas çdo lënde detyrat përkatëse siç përcaktohet në syllabusin e çdo lënde të ofruar në kurrikulën e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konfirmoi që IAL ka përdorur një sërë kriteresh të shtrira përgjatë gjithë semestrit të cilat reflektohen dhe në vlerësimin final.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekretit dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Njëkohësisht institucioni përdor programin Turnitin në lidhje me kontrollin e plagjiaturës në punimet e studenteve, proces që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së punimeve.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Testimi vlerësues për çdo lëndë ka specifikat dhe kërkesat e veta, detajet e të cilave gjenden në syllabuset përkatëse. Megjithëse shpërndarja e përqindjes së</p>

	<p>vlerësimit është e shpërndarë gjatë vitit dhe konkludohet me një provim përfundimtar që në përgjithësi mban peshën më të lartë të vlerësimit.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj.</p> <p><i>Aneks 4_Rregullore Didaktike (Neni 30)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë kryesore dhe bazë, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim. Gjithashtu, institucioni ka program antiplagjaturë (Turnitin) që evidenton këtë mangësi për punimet e mikrotezave të studentit. Për të minimizuar këtë, nga takimi me stafin e departamentit, u evidentua rëndësia që i jepej punimit të mikrotezës, të bazuara në raste studimore.</p> <p><i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB (Kreu IV, pika 1,j)</i> <i>Aneks 9_Rregullore e Etikës</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në DVV, GVJ konstaton që çdo dorëzim detyre, provimi, ose mënyre tjetër vlerësimi është parashikuar me data përkatëse në fillim të semestrit dhe reflekton në data specifike në syllabus dhe kalendar akademik. Rezultati i çdo vlerësimi, sipas planprogramit lëndor, bëhet publik nga platforma e sistemit PITAGORA, nota/pikët e vlerësimit të dhëna në çdo vlerësim tregohen menjëherë dhe u dërgohen studentëve me e-mail, duke vënë në dispozicion një datë për të diskutuar dhe komentuar vlerësimin.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut,</p>	<p>Sipas rregullores didaktike të institucionit përcaktohet e drejta e studentit jo vetëm për tu njohur me vlerësimin por edhe për tu informuar më në thellësi për mënyrën se si është vlerësuar puna e tij. Në rast ankimi nga ana e studentit, studenti ka të drejtë të</p>

<p>rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>kërkojë rishikimin e provimit nga ana e komisionit të vlerësimit. Nëse përsëri studenti nuk është i kënaqur nga vlerësimi, studenti ka të drejtë sipas rregullores të kërkojë ngritjen e një komisioni të pavaruar dhe rishqyrtimin e provimit.</p> <p><i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i></p>						
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në raste të veçanta kërkesë ankimi të provimit, ngrihet një komision i posaçëm për rivlerësimin e provimit, me tre anëtarë, në përbërjen e të cilit nuk është pedagogu i lëndës. Komisioni vendos nëse vlerësimi ka qenë korrekt ose jo, dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas rastit, duke dhënë rezultatin përfundimtar. Detajet gjenden në rregulloren didaktike institucionale. GVJ konstatoi që PS ndiqte një procedurë efektive të dokumentuar dhe arkivuar.</p> <p><i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti me anë të sistemeve antiplagjiaturë, dhe shpërndarje të notës me vlerësime gjatë semestrit. Njëkohësisht, Institucioni ndjek procedura të posaçme në rast ankimi note dhe vlerësimi, të cilat mbështeten dhe në rregulloret përkatëse.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="596 1115 775 1196">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="775 1115 967 1196">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="967 1115 1161 1196">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="596 1196 775 1232"></td> <td data-bbox="775 1196 967 1232"></td> <td data-bbox="967 1196 1161 1232" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit në Administrim Biznes, ku FPMMU i UP tashme ka një historik dhe eksperiencë pozitive. Nga shqyrtimi i syllabuseve vihet re që ka një trajtim fillimisht të koncepteve bazë në administrim biznes që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e administrim biznesit.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e menaxhimit. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e aplikimeve të programeve në</p>




	<p>fushen e bizneseve, ate financiare, auditin apo modelimin e bizneseve dixhitale në praktikë. Mbështetur në 19 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teoriko shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e menaxhimit për disa nga sektorët e ekonomisë. Modulet si “Auditim” apo “Analizë Biznesi” të gërshetuara me “Metodat e Kërkimit Shkencor” zhvillojnë aftësi të veçanta për një menaxher biznesesh që formohet me një bazë të shëndoshë analitike.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Gjithashtu, pedagogu i lëndës përkatëse, në fund të zhvillimit të mësimin, bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin e njohurive të marra kryesisht në lëndët karakterizuese që lidhen me administrim biznesin. Kjo u evidentua në takimin me stafin që mbulon këtë program.</p> <p>Stafi akademik që mbulon këtë program realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marrë nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse. Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrikë për këtë qëllim.</p> <p><i>Ashtu siç u rekomandua në Standardin II, 4, Kriteri 4, GVJ rekomandon që programi i studimit të ofrojë punë laboratorike për lëndë specifike si “Biznesi Dixhital”, “Financa”, apo dhe</i></p>

	<p>“Metodat e Kërkimit Shkencor”, duke mbështetur kështu rritjen e kapaciteteve dhe njohurive për këto lëndë.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Anëtarë të stafit kanë marrë eksperiencë dhe njohuri bashkëkohore mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, kryesisht nëpërmjet angazhimit individual, vizitave në institucione universitare të huaja në kuadër të projekteve ERASMUS, apo gjatë angazhimit në projekte. Mbështetur në vizitën në institucion evidentohet edhe realizimi i leksioneve të hapura me staf akademik të fushës apo specialistë të saj.</p> <p><i>Aneks 41_Mobileteti i stafit</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjatë realizimit të praktikës. Konkretisht, UP është një ndër partnerët e Tirana Inc., inkubatori i bizneseve, i cili ofron mbështetje në infrastrukturë, financim, mentorim të ideve inovative të studentëve dhe akademikëve të rinj.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p> <p>https://www.tirana-inc.al/</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit MSH në “Administrim Biznesi” garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet disa moduleve specifike si “Auditim” apo “Analizë Biznesi” të gërshetuara me “Metodat e Kërkimit Shkencor” të cilat ndihmojnë në formimin e menaxhereve të kësaj fushe. Gjithashtu GVJ evidentoi kapacitetet e institucionit dhe stafit akademik në mbështetje të studentëve me përfshirjen e tyre në inkubatore biznesi dhe praktika profesionale. Krahas praktikave profesionale, GVJ rekomandon se programi i studimit duhet të ketë ndërthurje të praktikave laboratorike dhe platformave digjitale për realizimin e lëndëve të caktuara.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi III.5**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë lëndëve të Vitit të I, pra 60 kredite, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi në semestrin e parë të Vitit II “Teze dhe Projekt Diplome (Project Proposal)” dhe në semestrin e dytë të Vitit II “Teze dhe Projekt Diplome”. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e pergjithshme të UP dhe rregulloren e Diplomimit. Ky proces është me i detajuar në rregulloren e Diplomimit. Në këtë rregullore jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të Tezës dhe Projektit të Diplomës, ndjekjes së pedagogëve udhëheqës, mënyrës së mbrojtjes dhe dorëzimit.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Për studentët që plotësojnë kriteret për zhvillimin e temës së diplomës, punimi është i pavarur dhe krijues dhe synon të vërtetojë fitimin e aftësive dhe të kompetencave profesionale ose të njohurive të parashikuara. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme. Detajet gjenden në dokumentin “Rregulloren e Diplomimit”. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se PS ka vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Tezës dhe Projektit të Diplomimit gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e</p>



<p>miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p>Nga takimi me studentët e Vitit të II-të të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruar. Në rastin e punimeve të Tezës dhe Projektit të Diplomimit për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zerë një peshë të konsiderueshme.</p> <p><i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.</p> <p><i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i pavarur nga procesi i përpilimit të diplomës në vazhdim, vlerëson studentin nëpërmjet notimit në përputhje me rregulloren e diplomimit, sipas së cilës mentori e vlerëson studentin me 30% të totalit të pikëve. Vlerësimi përfundimtar i diplomës së studentit kryhet nëpërmjet një vlerësimi me tre komponentë, ku vlerësimi përfundimtar përcaktohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi vizual i oponentit me 20% të totalit të pikëve; - vlerësimi vizual i udhëheqësit me 30% të pikëve totale, dhe - vlerësimi i komisionit të diplomës me 50% të totalit të pikëve, duke përfunduar vlerësimin prej 100 pikësh. <p><i>Aneks 7_Rregullore diplomimi MSC AB</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. Gjithashtu, pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit sapo ai bën edhe kërkesën përkatëse.</p> <p><i>Aneks 19_Diplomë_Suplementi Diplomës_MSc.AB</i></p>

zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>Aneks 46_Kurs Katalogu MBA Vizita në Institucion, takimi me sekretarinë e institucionit</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit (PITAGORA). <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike Vizita në Institucion, takimi me sekretarinë e institucionit</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka një procedurë të rregullt për mbrojtjen përfundimtare të përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të UP dhe rregulloren e Diplomimit, ku dhe gjenden detajet lidhur me strukturën e punimit të Tezës dhe Projektit të Diplomës, ndjekjes së pedagogëve udhëheqës, mënyrës së mbrojtjes dhe dorëzimit. Njëkohësisht Rregullorja përkatëse ka parashikuar dhe një proces rigoroz me një Komision të pavarur nga procesi i përpilimit të diplomës në vazhdim, i cili vlerëson studentin nëpërmjet notimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky standard nuk është i vlefshëm për këtë program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e	

shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.			
Konkluzione			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) ku specifikohet informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se UP ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër.</p> <p>Nga të dhënat e paraqitura rezulton si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 21-22 janë angazhuar: 6 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., dhe 5 Dr., dhe 7 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Dr. dhe 2 Msc. - Në vitin akademik 22-23 janë angazhuar: 12 PAE, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 8 Dr. Dhe 2 Msc., dhe 9 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 1 Prof.As., 2 Dr. dhe 5 Msc. <p>Për sa më lart, konstatohet se në këtë program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc., në kundërshtim me parashikimin e nenit 59, pika 6, të LAL 80/2015, ku citohet se: “Personeli</p>

	<p><i>akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.</i></p> <p>Gjithashtu, nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi, konstatohet se <i>jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë “Profesor”, sikurse kërkohet në nenin 59, pika 3, të LAL 80/2015.</i></p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 30_CV-te e stafit te angazhuar ne program</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabelat 6)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e përcjella nga UP, mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2021-2022: 50% (372 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 50% (372 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK; - Në vitin akademik 2022-2023: 67.4% (1312 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 32.6% (636 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK. <p>Për sa më lart, konstatohet se <i>ngarkesa mësimore nuk mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv.</i></p> <p><i>Aneks shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (Tabelat 4 dhe 12)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit. GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik me grade shkencore kane një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ konstaton se IAL se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e përbashkët të rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master është shumë të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel i cili është prej vitesh pjesë e Universitetit Polis, duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Kontratat e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme hartohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p>

	<p><i>Aneks 30_CV-te e stafit te angazhuar ne program</i> <i>Aneks 50_Model kontrate PAK/PAE</i> <i>Aneks shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme siç u verifikua nga tabelat e të dhënave. Procesi i seleksionimit të kandidatëve kalon në disa faza, procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një kërkesë për rekrutim stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidaturave, kriteret që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së BNJ dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen tek rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në ëeb faqen e Institucionit por edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë. Rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit e cila kalon në dy faza: faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të kërkesave të kandidatëve që janë dorëuar pranë zyrës së BNJ, kurse faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi të kandidatëve e cila i përcillet Rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i Rektorit.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e BNJ u kërkua të shikohej e verifikohet procedura për rekrutimet më të fundit dhe dokumentacioni që ka shoqëruar procesin dhe u konstatua se në dosjet respektive ishin ruajtur dokumentat e kërkua.</p> <p><i>Aneks 51_Formular për shpalljen e vendit vakant</i> <i>Aneks 52_Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit</i> <i>Aneks shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, ka në përbërje te tij edhe staf ndihmës akademik, të cilët janë</p>



<p>dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>përgjegjës për mirëmbajtjen e laboratorëve. Gjatë orëve të laboratorit, stafi akademik përgjegjës për lëndët në të cilat do të zhvillohen laboratorët, do të kryejnë laboratorët në prezencë të stafit ndihmës akademik, i cili asiston në mbarëvajtjen e këtij procesi.</p> <p><i>Aneks 30_ CV-te e stafit te angazhuar ne program</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës_ Tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UP ka në strukturën e tij edhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ të punësuar. Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet dokumentacioni i nevojshëm dhe i gjithë dokumentacioni është i përfshirë në një dosje të vetme. GVJ u informua se të dhënat përditësohen periodikisht në fillim të vitit akademik ose atëherë kur kjo është e nevojshme si p.sh. shtimi i ndonjë gradë shkencore ose titulli akademik, etj.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_ Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_ Universiteti POLIS_ Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_ Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me grupe interesi dhe partnerë si në fushën e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe me subjekte private dhe shtetërore. Institucioni si edhe subjekti pritës për praktikën firmos kontratën e praktikës në të cilën përcaktohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet mes palëve. Subjekti pritës e udhëzon dhe e angazhon studentin gjatë periudhës së praktikës në detyra të ndryshme që lidhen me objektivat e formimit të programit të studimit, duke patur gjithmonë një person (punonjës të kompanisë) i cili mbikëqyr dhe udhëzon studentin.</p> <p>Punimi i diplomës kryhet nga studenti duke patur udhëheqës staf akademik të UP me grada dhe tituj duke respektuar ligjet ne fuqi sikurse edhe rregulloret përkatëse të Institucionit dhe të programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 47_ Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional</i></p>

<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Subjekti pritës, për praktikën profesionale të studentit, përcakton një person përgjegjës i cili duhet të udhëzojë studentin në të gjitha detyrat që ai duhet të kryejë.</p> <p>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit relacionin e praktikës, të cilën më pas e prezanton para komisionit të ngritur në nivel departamenti. Pas përfundimit të praktikës, studenti dorëzon relacionin e praktikës shoqëruar me një formular vlerësimi për të të bërë nga subjekti në të cilën është kryer praktika profesionale.</p> <p><i>Aneks 47_Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional</i></p> <p><i>Aneks 48_Formulari për kryerjen e praktikës/internshipit</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në këtë program studimi të ciklit të dytë "Master i Shkencave" është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc., jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë "Profesor", si dhe ngarkesa mësimore nuk mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv, sikurse kërkohet nga parashikimet ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është personel i cili është prej vitesh pjesë e Universitetit Polis, duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.</i></p> <p><i>Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, si dhe Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar.</i></p> <p><i>Institucioni ka marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani në kuadër të realizimit të praktikës profesionale, punimit të diplomës apo veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit dhe vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se UP e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimi si bibliotekë, sallë interneti, etj. Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se në funksion të fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, sallë interneti, sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj.</p> <p><i>Aneks 28_Planimetria dhe sipërfaqet Vizita në institucion, ambjentet e UP</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV, GVJ konstatoi se ambientet mësimore në POLIS ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p> <p><i>Aneks 28_Planimetria dhe sipërfaqet Vizita në institucion, ambjentet e UP</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit ka në dispozicion laboratorë informatike. Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratorëve nuk është i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p><i>Aneks 28_Planimetria dhe sipërfaqet Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit dhe vizita në ambjentet e UP</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe</p>	<p>Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni listohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive</p>

<p>subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me institucione të tjera. Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale janë hartuar me qëllim që studentët përvec anës teorike të mësojnë dhe anën praktike. Po kështu, gjatë vizitës në Institucion, studentët konfirmuan angazhimin e POLIS për praktikat e tyre.</p> <p><i>Aneks 47_ institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional</i></p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Polis e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe nga vizita në Institucion, nga takimet me stafin akademik, evidenton se literatura bazë dhe ajo ndihmëse e përdorur është literaturë e viteve të fundit dhe garanton përcjelljen në mënyrë efektive të dijeve dhe njohurive tek studentët e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p><i>Evidenca 15_ Syllabuset e Moduleve</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik të programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni referohet se në bibliotekën online JSTOR, ka abonim vjetor, ka mundësi aksesit deri në 85.000 tituj librash. Ky fond librash, bashkë me ato që ofron Edëard Elgar Publishing, Cobiss.al dhe Springer books, janë në dispozicion të personelit dhe studentëve pa pagesë, në funksion të punës mësimore dhe shkencore sipas fushave të interesit.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste</p>	

<p>mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se Universiteti Polis zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu është në dispozicion të studentëve një bibliotekë e pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, 10 prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online. Në ambientet e bibliotekës gjenden vende të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë, ndaj <i>sugjerohet shtimi i kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u njoh me ambientet e bibliotekës dhe procedurat e përdorimit të saj nga ana e studentëve. Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore në gjuhën shqipe të hartuar nga pedagogë të këtij universiteti si edhe nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend. UP ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të programeve të studimit. Studentëve u mundësohet dhe aksesimi në Bibliotekën Dixhitale EBSCO. Gjatë vizitës në sallën e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesimi në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të Universitetit.</p>
	<p><i>Aneksi 31_1 broshura e bibliotekës</i> www.universitetipolis.edu.al/biblo_polis <i>Vizita në Institucion, ambientet e IAL</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimit në programet e studimit. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Orari i funksionimit të bibliotekës është nga e hëna në të premte në orarin 08:30-16:30 dhe në fundjavë në orarin 09:00-17:00 gjatë ndjekjes së programeve master. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër të studentëve të programit të studimit Master Shkencor dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.</p>
	<p><i>Aneksi 31_1 broshura e bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, biblioteka</i></p>


<p>Kriteri 8.Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, në kuadër edhe të projekteve në të cilat ka marrë pjesë, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.</p> <p><i>Aneksi 31_1 broshura e bibliotekes</i> <i>Vizita në institucion, biblioteka.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universitetit POLIS zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Gjithashtu ky institucion ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni menaxhon të dhënat e tij përmes platformës Pitagora. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet për të aksesuar sistemin dhe me emailt institucionale. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Regjistrimit të arritjeve akademike dhe Regjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Aneks 21.4_Manuali i regjistrimit te studenteve</i></p>

	<i>Vizitë në sekretarinë mësimore</i>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm Pitagora disponon informacion edhe mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ. Ky informacion i shërben zyrës juridike të depozitohet një dosje të veçantë për gjithë personelin, si dhe krijon një lidhje ndërmjet sekretarisë mësimore, pedagogut dhe fakultetit.</p> <p>Sistemi u mundëson informacion studentëve, personelit akademik dhe atij administrativ, zyrove të ndryshme në institucion. Studentëve u mundëson informacion lidhur me planprogramin e lëndës, vlerësimet e tyre, etj.; personelit akademik u mundëson informacion mbi statusin e studentit, rezultatet akademike të studentit, etj.; Zyra e Financës gjurmon tarifën e studimit të studentëve, etj.</p> <p>Studentët që në momentin e regjistrimit në një program studimi, pajisen me adresë email-i personale me anë të së cilës komunikojnë në vazhdimësi për çdo gjë me stafin akademik të programit, stafin administrativ, etj. Gjithashtu stafi akademik i programit të studimit komunikon me studentët nëpërmjet adresave të emailit të tyre por gjithashtu edhe nëpërmjet platformave të ndryshme si psh. Teams, për hedhjen e materiale apo leksioneve të ndryshme.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, ky Fakultet gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams si dhe ZOOM janë zhvilluar seanca mësimore gjatë pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektsh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë stafi dhe studentët janë të pajisur me adresa email-i zyrtare të formatit contact@universitetipolis.edu.al duke u përdorur edhe kjo formë komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 5_Rregullore Fakulteti_FPMMU</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	



	<i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të Universitetit Polis, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit, jepet informacion për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj. GVJ eksploroji mundësitë e ofruara për përftimin e informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë. <i>Website: https://universitetipolis.edu.al/</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Polis disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të Universitetit Polis, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel njësie kryesore mbulohet në nivel institucioni nga Administratori dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin Akademik dhe Rektorin e Universitetit Polis. Buxheti i alokohet sipas Njësisve Kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. GVJ konstatoi se nuk ka një detajim deri në nivel

	<p>programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Evidencë shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (tabela 18)</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në Statut përcaktohet se veprimtaria e Universitetit Polis financohet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; veprimtari kërkimore-shkencore; projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare. <p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjal administrativ i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Universitetit Polis. Me propozim të Senatit Akademik ai miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm si edhe garanton zbatimin e tij. Ai përcakton edhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që sigurohen nga ushtrimi i veprimtarisë si edhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit. Akti më i rëndësishëm në lidhje me aspektet e menaxhimit të institucionit është miratimi i Buxhetit të institucionit. GVJ konstatoi se procesi i hartimit të projekt buxhetit është gjithëpërfshirës dhe miratohet me vendim të Bordit të Administrimit.</p> <p>Çdo vit, pasqyrat financiare të Institucionit i nënshtrohen auditimit nga një kompani ndërkombëtare, e cila konfirmon vërtetësinë dhe pasqyrimin e drejtë të informacionit financiar.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_Universiteti POLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Evidencë shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse (tabela 18)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Universiteti Polis paraqet në MAS në fund të çdo viti akademik raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentura përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Zyra e Financës është përgjegjëse për raportimin e realizimit të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Planifikimet dhe ndërhyrjet parashikohen në buxhetet</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Universiteti Polis paraqet në MAS në fund të çdo viti akademik raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentura përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Zyra e Financës është përgjegjëse për raportimin e realizimit të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Planifikimet dhe ndërhyrjet parashikohen në buxhetet</p>

	afatmesme dhe ato synojnë garantimin e mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit. <i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_Universiteti POLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> https://universitetipolis.edu.al/organigrama/		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti Polis dhe programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit. <i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_Universiteti POLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> https://universitetipolis.edu.al/organigrama/ <i>Evidencë shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i>		
Konkluzione	<i>Universiteti Polis dhe programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë

<p>përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e Universitetit Polis, Rregulloren e Universitetit Polis, Rregulloren për Studimet Universitare dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3 _Rregullore e Pergjithshme _2022</i> <i>Aneks 6 _Rregullore programi MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se Universiteti Polis ndjek politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që garantojnë barazinë tek studentët në këtë program studimi. Statuti dhe rregulloret institucionale garantojnë mundësi të barabarta për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënies si edhe kërkimit shkencor. Procedurat e ndjekura janë në përputhje edhe me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore në fuqi të kërkuara edhe nga MAS. Veprimtaria mësimore organizohet, realizohet dhe mbikqyret dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e Arsimit të Lartë, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit, format e mësimdhënies, kërkesat për pjesëmarrjen e studentëve në mësim, kontrollin e dijeve dhe sistemin e vlerësimit, organizimin e praktikave profesionale, mënyrën e diplomimit etj., i gjejmë të shprehura në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Diplomimi i studentëve realizohet në përputhje me Rregulloren për Studimet Universitare dhe pajisja e studentit me diplomë sipas formatit të miratuar shoqërohet dhe me suplementin e diplomës. Të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3 _Rregullore e Pergjithshme _2022</i> <i>Aneks 6 _Rregullore programi MSc.AB</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit dhe procedurën për t'u ndjekur jepen në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Rregulloren didaktike. Njoftimet shoqëruar me kriteret e pranimit janë të aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit të Universitetit Polis.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_UniversitetiPOLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 4_Rregullore didaktike</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatën Akademik. Kriteret e pranimit bëhen publike në faqen e internetit. Elementë më të detajuar lidhur me pranimin dhe transferimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit (Neni 9 – Pranimi i studentëve). Përzgjedhja e aplikantëve fitues ose atyre që transferohen nga programe studimi të tjera kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur nga Dekani. Përzgjedhja kryhet mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit Bachelor x koeficient (për përputhmërinë e studimeve BsC me ato të MSc që po aplikon). Elementët e tjerë që lidhen me vlerësimin e dijeve) dhe diplomimin gjenden në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_UniversitetiPOLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_UniversitetiPOLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të</p>	<p>Universiteti Polis ndjek politika të mbështetjes së kategorive sociale të vecanta. Kriteret e vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga këto kategori bëhen publike para fillimit të vitit akademik në faqen web.</p>

pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	https://universitetipolis.edu.al/apliko-ne-universitetin-polis/ https://universitetipolis.edu.al/bursa-studimi/		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Në rregulloren e programit të studimit, neni 19, pika c, thuhet se në këtë program studimi kanë të drejtë të transferojnë studimet shtetas shqiptar ose të huaj, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullores së studimeve. janë vizitës në Institucion, GVJ nuk evidentoi ndonjë regjistrim të shtetasve të huaj në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentet</i></p>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Institucioni, ofron bursë apo përjashtim nga tarifa për vitin akademik për studentët, bazuar në mesataren e notave të arritura ose për shtresa në nevojë. Kjo përzgjedhje e studentëve, bëhet bazuar brenda kuadrit ligjor në vend dhe bazuar në Rregulloren për studimet universitare</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se për këtë program studimi nuk kishte studentë që përfitonin bursë apo përjashtim nga pagesa e tarifës për vitin akademik.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1_Statuti_UniversitetiPOLIS_Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3_Rregullore e Pergjithshme_2022</i> <i>Aneks 6_Rregullore programi MSc.AB.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentet</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin, Rregulloren e programit Msc Ab. Rregulloren e pergjithshme.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e

Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” realizohet me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

58

<p>procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>është 2 vjet. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite (60 vitin e parë dhe 60 vitin e dytë). Studimet e këtij programi përmbillen me punim diplome. Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit, por edhe në sistemin Pitagora. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden edhe në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3 _Rregullore e Pergjithshme _2022</i> <i>Aneks 6 _Rregullore programi MSc.AB.</i> <i>Aneks 36 _Guida e studentit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nene të ndryshme në statut jepin elementët që lidhen me transferimet dhe kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët apo kandidatët për këtë program studimi mund të njihen me këta elementë duke aksesuar rregulloren e studimeve në UP nëpërmjet website. Gjithashtu, elementë shtesë jepen edhe në Rregulloren e programit.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3 _Rregullore e Pergjithshme _2022</i> <i>Aneks 6 _Rregullore programi MSc.AB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit përftohet nëpërmjet Rregullores së pergjithshme dhe Rregullores së programit të studimit. GVJ u informua se elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse). Gjithashtu, studentët informohen në mënyrë periodike edhe përmes sistemit Pitagora, broshurave, website, etj.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3 _Rregullore e Pergjithshme _2022</i> <i>Aneks 6 _Rregullore programi MSc.AB.</i> <i>Aneks 35 _Politikat e marketingut</i></p>




<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit. Në planin mësimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 9 kredite ECTS. Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e diplomimit dhe formatin e mikrotezës së ciklit të dytë të studimeve e cila i vihet në dispozicion. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template dhe gjithashtu rregullat e punimit te paraqitjes se referencave.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 3 _Rregullore e Pergjithshme _2022</i> <i>Aneks 6 _Rregullore programi MSc.AB.</i> <i>Aneks 7 _Rregullore diplomimi</i></p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së pranimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësisë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Gjithashtu faqja e internetit (https://universitetipolis.edu.al) ofron një gamë të gjerë informacionesh në lidhje me kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional dhe planin mësimor të programit të studimit.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe zyrën e mbështetjes së studentëve dhe këshillimit të karrierës</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 1576 775 1653">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="775 1576 962 1653">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="962 1576 1171 1653">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1171 1576 1386 1653">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 1653 775 1688"></td> <td data-bbox="775 1653 962 1688"></td> <td data-bbox="962 1653 1171 1688"></td> <td data-bbox="1171 1653 1386 1688" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht						
			X						



Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, mbrojtje diplomash dhe praktikash mësimore etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të Universitetit Polis. Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programet e studimit/lëndët përkatëse.</p> <p><i>Aneks 36_Guida e studentit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GVJ u informua se syllabuset që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë. Gjithashtu, Universiteti Polis shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit dhe guidës së studentit ku pasqyrohen informacione si dhe një numër elementësh të tjerë që informojnë studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 29_Syllabuset e programit</i> <i>Aneks 36_Guida e studentit</i> <i>Aneks 44_Plani mësimor</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Në organigramën e Universitetit Polis, në varësi të Rektorit, është dhe Zyra e mbështetjes së studentëve dhe këshillimit të karrierës. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të qendrës së karrierës është dhe Alumni. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në koordinim të ngushtë me organet drejtuese të Universitetit Polis dhe ka në fokus</p>

	<p>mbarëvajtjen profesionale të individëve që kanë kryer studimet në U_Polis. Zyra shërben si një urë e drejtëpërdrejtë komunikimi mes tregut të punës dhe punëkërkuësve të ardhshëm (studentëve) nga çdo fushë studimi. Ky bashkepunim është frytdhënës për të dy palët, pasi Universiteti promovon studentët e tij dhe subjektet pjesëmarrëse rritin cilësisht burimet e tyre njerëzore.</p> <p>Në faqen e internetit në mënyrë të vazhdueshme publikohen njoftime për mundësi internship-i apo punësimi për studentët. GVJ, nga takimi i zhvilluar me zyrën e karrierës si dhe nga shqyrtimi i informacionit të DVV dhe faqes së internetit, është i mendimit se lidhja me biznesin është në nivele shumë të kënaqshme dhe se mbështetet fuqimisht orientimi i studentëve drejt dhe në tregun e punës.</p> <p><i>Aneks 21.1_Rregullore ZMSKK</i> <i>Aneks 27_Politika mbeshtetese dhe marreveshje bashkepunimi MSc.AB</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse</i> https://universitetipolis.edu.al/struktura-te-tjera-te-pavarura/ <i>Vizita në Institucion, takimi më Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimëve, struktura e vitit akademik, datat e provimeve apo datat e shlyerjeve të detyrimeve, aksesohen gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohen edhe njoftime për tarifat e studimit etj. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ u informua se sistemi Pitagora mundëson hyrje të dedikuara të studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion janë dhe faqet zyrtare ku informacioni është i drejtëpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve ndër të tjera mund të realizohet edhe nëpërmjet e-mailit.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e</i></p>




	<i>pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon të gjithë informacionin në lidhje me studentët e regjistruar në këtë program studimi, të larguar, diplomuar dhe të dhëna të tjera statistikore të cilat mbahen nga Sekretaria Mësimore. Ky informacion ruhet në format elektronik dhe hard copy dhe u verifikua edhe gjatë vizitës në Institucion, si: Regjistri Themeltar, Regjistri i Arritjeve Akademike, etj. <i>Evidencë shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe shërbimit për studentët. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit. Në Sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se Regjistri themeltar në momentin e vizitës, ishte i disponueshëm sipas formatit të miratuar nga QSHA. <i>Evidencë shitesë gjatë vizitës_Tabelat përmbledhëse Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nëpërmjet platformës Pitagora. Për të garantuar sigurinë e informacionit, hyrja realizohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. <i>Aneks 21.3_Manual_Perdorimi Studentet Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm	Institucioni mban të dhënat në mënyrë manuale në regjistra specifikë, gjithashtu edhe në mënyrë elektronike. Këto të dhëna kontrollohen nga personat e autorizuar dhe ruhen sipas rregulloreve përkatëse në Universitetin Polis.




të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>Aneks 21.3 Manual_Perdorimi Studentet</i> <i>Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i>		
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti, Sekretaria Mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Qendra e Karrierës dhe Alumni analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti, Fakulteti apo Universiteti. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. <i>Aneks 23_Analiza Mesimore dhe Kerkimore Shkencore</i> <i>Aneks 24_Axhenda e Kerkimit shkencor</i>		
Konkluzione	<i>Universiteti Polis mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe shërbimit për studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i Universitetit Polis përcakton se studentët, në përputhje me aktet ligjore dhe ato rregullatore, janë të përfaqësuar në Senatin Akademik dhe gjithashtu kanë senatin e tyre, marrin pjesë në Këshillin e Etikës, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Gjithashtu studentët mund të marrin pjesë edhe në Forumin Ekonomik Studentor. <i>Aneks 1_Statuti Universiteti Polis</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në	Bazuar në Statutin e Universitetit POLIS, studentët përfaqësohen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik

<p>vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>në Universitet, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Studentët kanë një organ të pavarur që është Këshilli Studentor, i cili promovon dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke mbajtur kontaktet me studentët dhe sugjerimet që studentët mund të kishin në raport me kurrikulën.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi Vizita në Institucion, takimi me GVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të institucionit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Mendimi për përmirësimin e programit të studimit merret edhe studentët alumni.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 22 _ZMSKK/Pyetësori Alumni</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJSBC dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. GVJ, bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konkludon se studentët kanë të drejtën e rivlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirëinformuar në këtë drejtim dhe se kishin patur raste të ballafaqimit me pedagogët përse i përket vlerësimit, por që nuk kishin arritur deri në fazën e paraqitjes së ankimimit me shkrim. Nga takimi i GVJ me studentët, rezultoi që procedura realizohet në përputhje me rregulloren. Gjithashtu Senati Studentor është pjesë e strukturës së Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i <i>Senatit Studentor</i> është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtaritë akademike, por dhe me të tjera që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve.</p>



	<p>Senati ka statutin e tij është autonom, mbështetet nga Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe përfaqëson zërin e studentëve në unanimitet. U_POLIS ka një Përfaqësues Studenti të zgjedhur përmes një procesi demokratik nga komuniteti bazuar në rregulloren e tij.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 22 _ZMSKK/Pyetësori Alumni</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Universiteti Polis garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në organe venimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi në Universitetin Polis ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UPolis. Institucioni mbështet dhe informon studentët nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) gjatë gjithë periudhës së studimit, e cila u mundëson studentëve informacionet e nevojshme lidhur me procesin mësimor, rregulloret e ndryshme, këshillim për praktikat profesionale, etj. Gjithashtu, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 1.1 _Statuti _UniversitetiPOLIS _Urdher-miratim-ndryshimi</i> <i>Aneks 22.1 _Rregullore ZMSKK</i> https://universitetipolis.edu.al <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës informon vazhdimisht studentët për çështje që lidhen me aspektet akademike dhe të drejtat e detyrimit e tyre, si dhe kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Kjo zyrë mban lidhje të vazhdueshme me kompani të ndryshme dhe informon studentët lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, si dhe i ofron studentëve këshillimin dhe orientimin e nevojshëm në lidhje me kryerjen e praktikave profesionale dhe orientimin e tyre në tregun e punës.</p> <p><i>Aneks 22.1 _Rregullore ZMSKK</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe studentët e programit</i></p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, përpos të tjerash, synon edhe grumbullimin e informacionit që lidhet me të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Ajo bashkëpunon ngushtë me drejtuesit e Shoqatës Studentore dhe Shoqatës Alumni dhe ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të mbajë kontakte individuale me studentët edhe pas diplomimit dhe punësimit të tyre, duke marrë vazhdimisht komentet e tyre; • të kryejë studime të përditësuara të tregut të punës dhe identifikimin e kërkesave të tij dhe vënien në dispozicion të studentëve; • të rregullojë dhe sigurojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, në proceset dhe aktivitetet kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera kërkimore-zhvilluese dhe shërbimet që u ofrohen; • trajnime për metodat e aplikimit në institucione të ndryshme dhe përgatitjen e dokumentacionit të aplikimit. <p><i>Aneks22.1 _Rregullore ZMSKK</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi në se Universiteti Polis ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të pritjes, orientimit, informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të këtij universiteti.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur evidentohet se, bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UP, janë ngitur dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, përkatësisht Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), funksionimi dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësive të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit, si dhe koordinon punën me njësinë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, që është Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban.</p> <p>NJSBC monitoron vlerësimet periodike dhe të dhënat e mbledhura nga studentët dhe stafi akademik trajtohen në formën e gjetjeve dhe pasqyrohen në formën e një raporti me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave për rastet kur është e nevojshme.</p> <p>Zhvillimi i vazhdueshëm i leksioneve të hapura, i vjen në ndihmë stafit të ri akademik për marrjen e eksperiencës dhe përvojës. Gjithashtu stafi akademik asistent lektor vlerësohet çdo vit nëpërmjet një formulari të hartuar dhe miratuar në Dekanat në lidhje me disa elementë të tilla si: komunikimi, aftësia për të punuar në grup, cilësia e mësimdhënies, risitë dhe inovacioni në mësimdhënie, kërkimi shkencor etj.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 8 _Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 34 _Raporti Vjetor NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të</p>	<p>Në përfundim të çdo semestri bëhet anketimi i studentëve përmes sistemit PITAGORA, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Gjetjet e pasqyruara në raport</p>

<p>vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>vihen në dispozicion përmes emailit, si dhe i prezantohen Senatit Akademik. Pjesë e këtyre vlerësimeve periodike të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve është edhe mundësia e trajtimit të ankimeve.</p> <p><i>Aneks 4_Rregullore Didaktike</i> <i>Aneks 8_Rregullore NJSBC</i> <i>Aneks 18_Formularët e Vlerësimit</i> <i>Aneks 21_Manualet e përdorimit pitagora</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Gjetjet e pasqyruara në raportin e NJSBC bëhen transparente dhe përcillen përmes emailit, si dhe i prezantohen Senatit Akademik, i cili organizon një mbledhje të hapur ku marrin pjesë stafi akademik, administrativ dhe përfaqësues të studentëve. Gjetjet e detajuara i përcillen secilit anëtar të stafit në mënyrë individuale përmes emailit. Këto të dhëna bëhen pjesë edhe të Raportit Vjetor të UP.</p> <p><i>Aneks 1_Statuti_Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 8_Rregullore NJSBC</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 53_Raporti Vjetor 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sikurse përmendur edhe më sipër, rezultatet e vlerësimit përmbledhen dhe pasqyrohen në formën e një Raporti Vjetor, i cili i vihet në dispozicion Senatit Akademik. Gjetjet e raportit diskutohen në nivel njësie bazë/kryesore, me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave në vijim, në rastet kur ka. Në përputhje me këto gjetje, Departamentet, me miratimin e Dekanatit, rishikojnë metodologjinë, lëndët, literaturën, etj. me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe procesit të mësimdhënies në vijim. Gjithashtu, me qëllim nxitjen dhe promovimin e stafit, në UP hartohet Raporti Vjetor për Kërkimin Shkencor, në të cilin pasqyrohen rezultatet dhe arritjet shkencore të stafit dhe mbi të cilin hartohet edhe sistemi i pikësimit.</p> <p><i>Aneks 23_Raport, Veprimtaria e Kerkimit Shkencor 21-22</i> <i>Aneks 25_Sistem pikesimi</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Polis ka të ngritura dhe funksionale struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		Përmbushet plotësisht
	measurisht	kryesisht	
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UP, bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore, ka të ngritur dhe funksionale Njësinë e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), si një njësi vlerësimi të përherëshme, përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë, funksionimi dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë, me përfaqësues të stafit akademik, stafit administrativ, një ekspert të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve aktualë dhe atyre alumni. Sipas Statutit të UP, kjo njësi ka për detyrë të bëjë vlerësimin e të gjithë elementëve të cilësisë sipas standardeve të ENQA-s, të vlerësojë periodikisht procesin mësimor, si dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Kjo njësi synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike, në mënyrë që çdo aspekt në UP të shihet në kuadër të cilësisë, përmes krijimit dhe konsolidimit të kulturës së cilësisë. NJBSC, me zgjerimin e fushës së saj të veprimtarisë, tashmë mbulon edhe funksionet kërkimore dhe administrative.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 8 _Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 34 _Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 53 _Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës _Tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UP përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>Një prej proceseve që ndihmon në përmirësimin e cilësisë është edhe vlerësimi i jashtëm i cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucionit dhe programeve të studimit. Në kuadër të këtij procesi, i cili realizohet nga ASCAL, UP harton dhe përgatit Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit.</p>

	<p>Një tjetër ndihmesë në kuadër të përmirësimit dhe promovimit të cilësisë, ka qenë edhe angazhimi i UP në projektin Erasmus+, Key Action 2, QAINAL “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri”, në të cilin kanë marrë pjesë staf të UP dhe anëtarë të NJBSC.</p> <p><i>Aneks 8_Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 53_Raporti Vjetor 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik realizohet nga 4 komponentë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi nga studentët, pesha e së cilit zë 50% të vlerësimit total. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimin e tyre përmes një pyetësi anonim, i cili realizohet elektronikisht përmes sistemit PITAGORA, lidhur me programin e studimit, lëndët, pedagogët, etj. 2. Vlerësimi nga kolegët, pesha e së cilit zë 35% të vlerësimit total. Ky vlerësim realizohet përmes ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët, bazuar në një kalendar nëpërmjet të cilit përcaktohen afatet kohore se kur duhet të përfundojë vlerësimi. 3. Vetë-vlerësimi, pesha e së cilit zë 15% të vlerësimit total. Përmes këtij vlerësimi dëshmohet shkalla e njohjes së vetë pedagogëve për cilësinë dhe shkallën e vetkritikës me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual. 4. Vlerësimi nga drejtuesit, i cili realizohet përmes një procesi analize dhe feedback të kombinuar me analizat semestrale. Me stafin e ri, ky proces përfshin dhe fokusohet në këshillimin, orientimin, njohjen me praktikën më të mira, me synim përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e sensit vetkritik. Vlerësimi shërbim si vlerësim përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik, duke përfshirë edhe punën shkencore dhe bazohet në rezultatet e vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe të vetëvlerësimit. <p>Gjithashtu, procese të tjera vlerësimi periodike të njësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i proceseve administrative; - vlerësimi i performancës akademike mbi angazhimin në punët kërkimore; - hartimi i raporteve individuale dhe bashkëbisedimeve konstruktive mbi performancën vjetore të stafit akademik / administrativ;


	<p>- hartimi i raportit vjetor të njësisë në fund të çdo viti akademik, rezultatet e të cilit i bëhen të ditura stafit dhe studentëve.</p> <p>Të gjitha gjetjet bëhen pjesë e Raporteve të pjesshme dhe vjetore të Njësisë, si dhe Raportit Vjetor të Institucionit.</p> <p><i>Aneks 8_Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 18.1_Formularët e vlerësimit për këtë proces</i> <i>Aneks 18.2_Formulari për vlerësimin e proceseve administrative</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 53_Raporti Vjetor 2021-2022</i></p>						
Konkluzione	<i>Universiteti Polis harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni punon për të arritur rezultate sa më maksimale si në rritjen e procesit mësimor, ashtu edhe në promovimin e stafit akademik. Në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme. Programi i studimit vlerësohet në fund të çdo semestri, nga disa komponentë dhe rezultatet bëhen pjesë e një analize vjetore dhe pasqyrohet në formën e një raporti.</p> <p>UP ndjek dhe zbaton edhe mekanizma të tjera si grupe pune për probleme të veçanta, organet kolegjiale të përhershme brenda njësive kryesore, apo konsultimet me specialistë të fushës, brenda dhe jashtë institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e</p>	<p>Gjetjet e këtyre vlerësimeve bëhen pjesë e Raporteve të pjesshme dhe vjetore të Njësisë, si dhe Raportit Vjetor të Institucionit.</p> <p><i>Aneks 8_Rregullore NJBSC</i></p>

<p>marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>Aneks 18.1_Formularët e vlerësimit për këtë proces</i> <i>Aneks 18.2_Formulari për vlerësimin e proceseve administrative</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 53_Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UP përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>NJBSC është struktura përgjegjëse për realizimin e monitorimit të aktivitetit dhe rezultatet e tij i përcillen Rektoratit dhe Dekanateve, dhe gjithashtu rezultatet e pyetësorëve i përcillen edhe stafit e studentëve.</p> <p>Nga të dhënat e raportuara, janë nxjerrë rekomandime lidhur me rregullsinë e procesit mësimor, cilësinë e mësimdhënies, janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime në rastet kur ka qenë e nevojshme, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>NJBSC monitoron në mënyrë të vazhdueshme: mënyrën e zhvillimit të lëndëve, rishikimin/përditësimin e tyre; ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimin e tij; procesin e mësimdhënies, ruajtjen e cilësisë dhe vlerësimin nga studentët; ecurinë e kërkimit shkencor; ecurinë e bashkëpunimit ndërmjet njësisive/strukturave brenda dhe institucionit; përfshirjen e studentëve në veprimtaritë akademike, konferenca, etj.</p> <p>Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi nga studentët; 2. Vlerësimi nga kolegët; 3. Vetë-vlerësimi; 4. Vlerësimi nga drejtuesit. <p>Gjithashtu, UP përdor e zbaton metoda të tjera si: sondazhe, takime të drejtpërdrejta, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve dhe punësimin e tyre, etj.</p> <p><i>Aneks 8_Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 18.1_Formularët e vlerësimit për këtë proces</i> <i>Aneks 18.2_Formulari për vlerësimin e proceseve administrative</i> <i>Aneks 34_Raporti Vjetor NJSBC</i> <i>Aneks 53_Raporti Vjetor 2021-2022</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>



Konkluzione	<i>GVJ evidenton se Universiteti Polis përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit, si dhe metoda e instrumente të drejtpërdrejta e të tërthorta në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në aktet ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të Institucionit, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga 9 anëtarë, me përfaqësues të stafit akademik, stafit administrativ, një ekspert të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve aktualë dhe atyre alumni. Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për aktorët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Edhe gjatë vizitës në institucion me këtë njësi, u evidentua qartë ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësisë. Gjithashtu, rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit, i cili shërben si lidhje midis studentëve dhe njësisë së cilësisë dhe njësisive të tjera.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	<i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 8 _Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës _Tabelat përmbledhëse</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në dokumentacion, si dhe në takimin që GVJ pati në institucion u konstatua se vazhdimisht merren parasysh mendimet e dhëna nga përfaqësues të bizneveve me të cilat UP ka marrëveshje bashkëpunimi, sikurse edhe analiza e tregut të punës, gjë që ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithashtu eksperiencia që stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus,
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

74



<p>brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>ndihmon gjithashtu në përmirësimet të vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj.</p> <p>UP ka të miratuar Rregulloren e Etikës, përmes së cilës bëhet e mundur ndërmjet të tjerash edhe mbrojtja nga diskriminimi apo pabarazia.</p> <p><i>Aneks 1 _Statuti _Universiteti POLIS</i> <i>Aneks 8 _Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 9 _Rregullore e Etikës</i> <i>Aneks 27 _Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e parteritetit Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti Polis përfshin aktorë të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konfirmon se përpos dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni në lidhje me procedurat dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në faqen web të UP si, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë.</p> <p>Raportet që NJBSC harton mbi gjetjet e proceseve të vlerësimeve periodike që realizon, krahas shpërndarjes përmes e-mail, prezantohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik, ku marrin pjesë stafi i institucionit, si dhe përfaqësues të studentëve, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim.</p> <p>UP, në bërjen publike të informacioneve, respekton Kodin e Etikës sikurse edhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjisllacionin për të dhënat personale.</p>	<p><i>Aneks 8 _Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 9 _Rregullore e Etikës</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i> https://www.universitetipolis.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

75

<p>masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sikurse është analizuar edhe më sipër, rezultatet e vlerësimit nga vlerësimet periodike mblidhen dhe pasqyrohen në formën e një raporti, i cili i përcillet Rektoratit dhe Senatit Akademik. Ky i fundit organizon një mbledhje të hapur me stafin e institucionit dhe përfaqësues të studentëve, për të diskutuar lidhur me gjetjet e raportit dhe përmirësimet të mundshme të nevojshme në vijim. Bazuar në gjetjet e raportit, njësitë bazë dhe kryesore analizojnë rezultatet dhe marrin masa, kur është e nevojshme, për përmirësimin e metodologjisë, lëndëve, literaturës, etj.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p><i>Aneks 8_Rregullore NJBSC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i> https://www.universitetipolis.edu.al/</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri. Theksohet vazhdimisht tek studentët roli që ata kanë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit duke i ndërgjegjësuar për plotësimin e pyetësorit online. Gjithashtu stafi akademik dhe ndihmës akademik kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme në kuadër të sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Aneks 56_Njoftime të dërguara me qëllim informimi ose zhvillimin e takimeve nga NJBSC</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe NJBSC</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se politikat dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë publike dhe transparente. Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	------------------------------	-----------------------------	---

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “POLIS”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Fakulteti dhe Departamenti ka fituar eksperiencë, çka e lehtëson procesin e realizimit të programit të studimit në kërkesat e standardeve.
2. Lidhjet e programit me bizneset si dhe numri relativisht i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit me to është një shenjë e mirë e materializimit në terren të formimit teorik dhe konkretizimit të praktikave manaxheriale dhe financiare të lëndëve specifike.
3. Infrastrukturat në dispozicion të programit janë të mjaftueshme dhe brenda standardeve duke krijuar mundësi dhe lehtësi për procesin e mësimdhënies.
4. Ngarkesa e numrit të studentëve për një pedagog nuk është e lartë, çka premtion për ndjekjen e tyre edhe në veprimtaritë jashtë fakultetit.
5. Ndjekja e studentëve mbas diplomimit dhe raportet e tyre deri pesë vite mbas punësimit është një praktikë e mirë.

Pika të dobëta:

1. Ndarja e lëndëve sipas kategorive formuese, nga A në E, nuk është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, përkatësisht kategoria D e cila është 7.5% (9 ECTS), ndërkohë që sipas kësaj VKM-je duhet të jetë 10%. (*Standardi II. 1, Kriteri 1*)
2. Pjesa më e madhe e syllabuseve nuk kanë formatin standard që përmbajnë të gjithë elementët përkatës komfort ligjit. Gjithashtu, jo të gjithë syllabuset kanë të listuara tematikat për 14 javë që janë pjesë e semestrit dhe vetëm disa prej tyre kanë si referencë literaturë të viteve të fundit. (*Standardi II. 3, Kriteri 4*)
3. Ndërkohë që programi i studimit ofron lëndë inovatore për fushën e studimit, mungon ndërthurja e praktikës laboratorike dhe platformave dixhitale për realizimin e disa lëndëve që janë të një rëndësie të veçantë të trajtohen dhe në këto drejtime. (*Standardi II. 4, Kriteri 4*)
4. Në këtë program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me Msc., jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë “Profesor”, si dhe ngarkesa mësimore nuk mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv. (*Standardi IV.1, Kriteri 1 dhe 2*)

Rekomandime:

1. Departamenti duhet të marrë masat përkatëse që ky program studimi të jetë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të VKM Nr. 41, datë 21.01.2018, i ndryshuar, në lidhje me ndarjen e % të lëndëve sipas kategorive formuese, nga A në E.



2. Me qëllim përmirësimit dhe përshtatjen me Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, Departamenti duhet të marrë masa për sa në vijim:
 - a) të përdoret formati standard i detajuar me elementët përkatës sipas VKM 41/2018, i ndryshuar. Temat e lëndës të ketë si shpjegim prej rreth një paragrafi për çdo temë të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe);
 - b) tematikat e lëndës të kenë një shpërndarje javore, për 14 javë;
 - c) literatura e përdorur të jetë e viteve të fundit.
3. Programi i studimit duhet të ketë ndërthurje të praktikave laboratorike dhe platformave dixhitale për realizimin e lëndëve të caktuara si “Biznesi Dixhital”, “Financa”, apo dhe “Metodat e Kërkimit Shkencor”.
4. IAL të marrë masa:
 - a) të angazhojë në mësimdhënie në këtë program studimi, personel akademik me grada shkencore/tituj akademikë;
 - b) të caktojë si titullarë lëndësh personel akademik të kategorisë “Profesor”;
 - c) ngarkesa mësimore e programit të studimit të mbulohet nga personel akademik efektiv në masën të paktën 70%.


Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Science in “Business Administration”, provided by the Higher Education Institution “POLIS” University

Strengths and affirmations:

1. The Faculty and the Department has gained experience, which facilitates the process of implementing the study program in standards requirements.
2. Program links with businesses as well as the relatively high number of cooperation agreements with them is a good sign of materialization in the theoretical training and concretization of the accounting and financial practices of specific subjects.
3. The infrastructures available to the program are sufficient and within the standards creating opportunities and facilities for the teaching process.
4. The number of students for a lecturer is not high that promises to pursue them in activities inside as well as outside the faculty.
5. Following students after graduation and their reports up to five years after employment is a good practice.

Weaknesses:

1. The division of subjects according to formative categories, from A to E, is not in accordance with VKM No. 41, dated 21.01.2018 “*On the elements of study programs offered by higher education institutions*”, as amended, specifically category D which is




7.5% (9 ECTS), while according to this VKM it should be 10 %. (*Standard II. 1, Criterion 1*)

2. Most of the syllabuses do not have the standard format that contains all the elements relevant to the law. Also, not all syllabuses have the topics listed for the 14 weeks that are part of the semester and only some of them refer to literature from recent years. (*Standard II. 3, Criterion 4*)
3. While the study program offers innovative subjects for the field of study, there is a lack of integration of laboratory practice and digital platforms to the realization of some subjects that are of particular importance to be addressed in these directions as well. (*Standard II. 4, Criterion 4*)
4. In this second cycle “Master of Science” study program, academic staff with Msc., is engaged in teaching, not all the holders of the subjects belong to the “Professor” category, and the teaching load is not covered to the extent of at least 70% by effective academic staff. (*Standard IV.1, Criterion 1 and 2*)

Recommendations:

1. The Department must take the relevant measures so that this study program is in full compliance with the legal requirements of VKM No. 41, dated 21.01.2018, as amended, regarding the % division of subjects according to formative categories, from A to E.
2. In order to improve and adapt to the Decision of CM No. 41, dated 24.01.2018, as amended, the Department must:
 - a) use the detailed standard format of syllabi with the relevant elements according to VKM 41/2018, amended. The subjects of the course should have an explanation of about one paragraph for each topic of the lecture according to the weeks, accompanied by the relevant literature (detailed with pages);
 - b) ensure that the topics of the course have a weekly distribution, for 14 weeks;
 - c) ensure that the literature used to be from recent years.
3. The study program must have a combination of laboratory practices and digital platforms for the realization of certain subjects such as “Digital Business”, “Finance”, or “Scientific Research Methods”.
4. HEI should take measures to:
 - a) engage in teaching in this study program, academic staff with scientific degrees/academic titles;
 - b) appoint as subject holders academic staff of “Professor” category;
 - c) cover the teaching load of the study program by effective academic staff to the extent of at least 70%.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

